

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

3 VJET ILD, MË SHUMË LEHTËSI PËR ANKUESIT

Pyetje të shpeshta mbi ankesat në ILD

- ▶ PËR CFARË SHËRBEN ANKIMIMI? ▾
- ▶ PËR CFARË MUND TË ANKOHEM PRANË ILD? ▾
- ▶ NDAJ KUJT NUK MUND TË PARAQES ANKESË NË ILD? ▾
- ▶ SI MUND TË PARAQES NJË ANKESË TEK ILD? ▾
- ▶ NUK ARRIJ TA PLOTËSOJ VETË ANKESËN ▾
- ▶ A ËSHTË MARRË ANKESA IME NGA ILD? ▾
- ▶ SA KOHË I DUHET ILD-SË PËR TË SHQYRTUAR ANKESËN TIME? ▾
- ▶ CILAT JANË KUSHTET PËR PRANIMIN E ANKESËS NGA ILD? ▾
- ▶ PSE ËSHTË ARKIVUAR ANKESA IME? ▾
- ▶ CFARË MUND TË BËJ NËSE NUK JAM DAKORD ME VENDIMIN E ARKIVIMIT APO
VENDIMIN PËR MBYLLJEN E HETIMIT NGA ILD? ▾
- ▶ SI MUND TË INFORMOHEM PËR ECURINË E ANKESËS SIME? ▾
- ▶ A MË MUNDËSON NJË VENDIM MË TË MIRË GJYQËSOR, KJO PROCEDURË NË ILD? ▾

Pyetje të shpeshta mbi ankesat në ILD

- ▶ PËR CFARË SHËRBEN ANKIMIMI?
- ▶ PËR CFARË MUND TË ANKOHEM PRANË ILD?
- ▶ NDAJ KUJT NUK MUND TË PARAQES ANKESË NË ILD?
- ▶ SI MUND TË PARAQES NJË ANKESË TEK ILD?
- ▶ NUK ARRIJ TA PLOTËSOJ VETË ANKESËN

3 VJET ILD, MË SHUMË LEHTËSI PËR ANKUESIT

Lehtësimit i procesit të ankimit mbetet një prioritet konstant i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në tre vite ekzistencë institucioni është përpjekur në vazhdimësi të qartësojë këtë proces, përmes publikimit të një formulari tip ankese në faqen zyrtare të internetit, i cili mund të dërgohet në tri mënyra: online, me postë ose personalisht. Po në faqe gjendet edhe një udhëzues për plotësimin e tij, si dhe një model i plotësuar ankese.

Duke patur në vëmendje të posaçme marrëdhënien me qytetarët, si një mënyrë për t'u përmirësuar dhe rritur besimin e publikut tek institucioni ynë, prej disa muajsh kemi vendosur një mënyrë direkte komunikimi, përmes një ankete të publikuar në faqen tonë mbi punën e institucionit.

Përgjigjet që marrim janë një element shumë i cmuar për të orientuar punën tonë në vazhdim.

PËR CFARË SHËRBEN ANKIMIMI? <

Ky proces bëhet për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve e prokurorëve të të gjitha niveleve:

1. Gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve;
2. Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
3. Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; dhe
4. Prokurorit të Përgjithshëm.

Përrjashtim bëjnë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë ankesë pranë ILD.

Shkeljet disiplinore hetohen nga ILD, bazuar në procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR CFARË MUND TË ANKOHEM PRANË ILD? <

Ju mund të ankoheni për veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, apo sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë, e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e Prokurorit të Përgjithshëm, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.

A MË MUNDËSON NJË

VENDIM MË TË MIRË

▶ GJYQËSOR, KJO PROCEDURË NË ILD? ◀

Jo! Ju lutem kini parasysh se Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka autoritet për të shqyrtuar apo ndryshuar vendimet e magjistratëve. Ato shqyrtohen nëpërmjet instrumenteve të apelimit gjyqësor, vetëm nga gjykatat më të larta. Inspektori i Lartë i Drejtësisë heton shkeljet disiplinore, që magjistratët mund të kryejnë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ose jashtë tij.

Pra, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka asnjë autoritet, që të ndikojë tek gjyqtari apo prokurori, që ju të merrni një rezultat të ndryshëm në çështjen tuaj. Nëse keni ndërmend të ndryshoni rezultatin e çështjes suaj, atëherë duhet të ndiqni rrugën e apelimit gjyqësor.

Bazuar në përgjigjet e marra deri tani, kemi vendosur të rishikojmë mënyrën e informimit të qytetarëve për mënyrën sesi mund të ankohen për shkeljet e gjyqtarëve e prokurorëve. Pyetjet që na drejtohen më shpesh nga qytetarët por edhe media, po i sjellim publikisht me përgjigjet përkatëse në rubrikën e ankesave, si një mënyrë për të qartësuar në mënyrë sa më shteruese gjithë procesin e ankimit pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Linku i pyetjeve të shpeshta për Ankesat:

<https://ild.al/sq/pyetje-te-shpeshta/>

Ju ftojme të na jepni mendimin tuaj për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke plotësuar anketën:

Anketa

<https://ild.al/sq/ankete/>

Anketë mbi veprimtarinë e ILD- së

1. Sa i informuar jeni mbi funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme. *

- Njoh pak sferën e kompetencave të ILD-së.
- Njoh kompetencat e ILD-së, pasi kam



METANI: MUNGESAT NË BURIME NJERËZORE NUK E KANË PENGUAR ILD-NË TË PERFORMOJË E VENDOSË STANDARDE PUNE PËR MAGJISTRATËT

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani këndvështrimet e tyre, ambasadorin e Holandës z. Reinout Vos, ministren dhe kryenegociatore znj. Majlinda Dhuka, kryetaren e Komisionit të Ligjeve znj. Klotilda Bushka, kryetaren e Komisionit të Ligjeve znj. Dhurata Çupi, kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Alfred Balla, përfaqësues të shoqërisë civile dhe inspektorë e anëtarë të Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky diskutim mbi ILD-në, si institucioni më i ri të Duke paraqitur konkluzionet e raportit të tij reformës në drejtësi bëri bashkë për të sjellë monitorues, pedagogu Erind Mërkuri u ndal



tek sfidat e ILD-së, të cilat kanë të bëjnë me numrin e lartë të ankesave ndaj gjyqtarëve e prokurorëve në raport me kapacitetet jo të plota të inspektimit, si dhe tek fakti se Kolegji i Lartë i Apelimit ka konfirmuar si të drejta procedurat disiplinore të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në përgjigje, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani vlerësoi monitorimin e detajuar

që i është bërë ILD-së, si mënyra e duhur për të matur me indikatorë të qartë punën e institucionit.

“Mungesa e burimeve njerëzore ka qenë vërtetë problem, por kjo nuk e ka penguar ILD-në, që të performojë dhe rezultatet duken. Drejtësia në këndvështrimin tim nuk është statistikë por rëndësi kanë standardet e vendosura dhe fakti që Këshillat, KLGJ e KLP, kanë konfirmuar gjithmonë gjetjet e ILD-së. Kjo





është vendosje standardesh, të cilat njëloj janë konfirmuar edhe nga KPA. Kjo do të thotë që sistemi funksionon dhe prandaj është e rëndësishme, që nëse vlerësohet puna e institucioneve, e ILD-së, duhet bërë me indikatorë si ky i sotmi, pra me indikatorë ku ka qenë, çfarë ka bërë dhe ku do shkojë.”

I pyetur nga moderuesi i takimit, gazetari Lutfi Dervishi për dimensionin tjetër të ILD-së, atë të inspektimeve, z. Metani tha se: “institucioni nuk duhet parë si një çekan mbi kokat e magjistratëve por si mekanizëm që ndihmon në evidentimin e standardeve të punës përmes inspektimeve institucionale apo te-





matike, pra ndihmesën që i jep gjyqtarëve e prokurorëve e vetë sistemit përmes rekomandimeve konkrete.”

Kryetarja e Komisionit të Ligjeve, znj. Klotilda Bushka vërejti se me gjithë punën e mirë, ILD nuk duhet të jetë i vetmi institucion që duhet ta mbajë sistemin të përgjegjshëm dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve të drejtësisë ndihmon në mbarëvajtjen e punës.





Nënkryetarja e Komisionit të Ligjeve, znj. Dhurata Çupi tha mes të tjerash, se mungesave me të cilat përballlet, duhet pranuar se rritja e numrit të ankesave është dëshmi e rritjes së besimit të qytetarëve tek inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe ky besim i

madh ndaj institucionit mbart me vete peshën e pritshmërisë së publikut prej tij dhe kjo është një tjetër sfidë për ILD-në. Kryetarja e KLGJ-së, znj. Naureda Llagami nënvizoi se pavarësisht pritshmërive, duhet pasur parasysh që institucionet kanë nevojë për kohë dhe vendosja e





standardeve si nga ILD, KLGJ e KLP është shumë e rëndësishme sepse tregon funksionimin e sistemit.

Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla vlerësoi punën e ILD-së në këto tre vite, ç'ka sipas tij duket edhe nga konfirmimi që KLP u ka bërë gjetjeve të ILD-së, në procedimet disiplinore ndaj prokurorëve.

Ministrja kryenegociatore znj. Majlinda Dhuka vlerësoi posaçërisht performancën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raportimet para Komisionit Europian në kuadër të procesit të shqyrtimit (screening) mbi kapitullin 23, të negociatave të anëtarësimit.

Ambasadori i Holandës, z. Reinout Vos duke konfirmuar mbështetjen e vendit të tij për forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë, vlerësoi rolin e ILD-së dhe nënvizoi se pas vettingut ky është institucioni perma-

nent, që mban përgjegjës gjyqtarët e prokurorët për standardet e punës së tyre. “Ambasada Holandeze po mbështet këtë aktivitet në kuadër të Muajit të Angazhimit Qytetar për Integrimin në BE dhe garanton angazhimin e saj për të mbetur një partner i rreptë, i drejtë dhe i angazhuar për të mbështetur Shqipërinë dhe përpjekjet e saj në rrugën e anëtarësimit në BE”, tha z. Vos.

Drejtuuesi i Institutit të Studimeve Politike, studiuesi Afrim Krasniqi u shpreh se edhe monitorimi i ILD-së tregon se pritshmëria më e madhe e reformës në drejtësi është nevoja për bilanc pune e jo vetëm për shifra e statistika vetting. “Dëshira jonë është që secili institucion të forcojë identitetin, pavarësinë dhe imazhin e vet publik dhe është e rëndësishme që secili të krijojë bilancin e tij e të marrë meritat në rast suksesi dhe përgjegjësitë në rast dështimi”, tha z. Krasniqi.

SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE
DHE ANKESAVE*Gjatë asistimit të ankuesve*

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku

ndodhet ankesa e tyre. Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Shkurt 2023**, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave ka pritur **19 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **4 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mundëson çdo kërkesë të drejtën për t'u njohur me informacionin publik sipas ligjit dhe komunikon me kërkesuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesat për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës, postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Shkurt 2023**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **14 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHKURTI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Shkurt** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 61 ankesa, 60 nga qytetarët dhe 1 e paraqitur nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit shkurt 2023. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME	HETIME DISIPLINORE
<ul style="list-style-type: none"> ◆ 16 vendime verifikimi, nga të cilat: ◆ 7 vendime verifikimi (Praktika të ILD-së); ◆ 9 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD); 	<ul style="list-style-type: none"> 2 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë 2 vendime për vazhdim hetimi disiplinor për 2 magjistratë 2 kërkesa për procedim disiplinor për një magjistrat
ARKIVIME	
<p><i>153 vendime arkivimi nga 209 praktika të shqyrtuara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ 31 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD); ◆ 70 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD); <p><i>52 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ 16 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD); ◆ 36 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD). 	

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Shkurt, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për 43 ankues, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 232 shpallje publike.

**NJOFTIM**

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit). Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NIS BASHKËPUNIMIN ME KËSHILLIN E SHTETIT TË GREQISË

Athinë, 2 Shkurt 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Athinë, me ftesë të Këshillit të Shtetit të Greqisë. Duke uruar mirëseardhjen kryetarja e Këshillit të Shtetit znj. Evangelia Nika pasi bëri një prezantim të Këshillit të Shtetit të Greqisë, nënvizoi se shkëmbimi i eksperiencave duhet të vijojë, pasi i shërben rritjes profesionale. Metani vlerësoi mikpritjen dhe bëri një paraqitje të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të praktikës së procesit disiplinor në Shqipëri.

Me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh në shkëmbimin e praktikave më të mira për hetimet disiplinore, inspektimet dhe çështjet me interes të për-

bashkët, z. Metani dhe znj. Nika nënshkruan një memorandum bashkëpunimi në respekt të interesit të përbashkët për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe duke u mbështetur në faktin se procesi disiplinor dhe inspektimi i sistemit të drejtësisë është një nga mekanizmat balancues, për të siguruar që sjellja e gjyqtarëve të bazohet në parimet e pavarësisë, legjitimitetit, paanësisë, përmes rritjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënie.

Memorandumi i bashkëpunimit mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë dhe Këshillit të Shtetit të Greqisë parashikon mes të tjerash, që palët të bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacione, praktika dhe përvoja në lidhje me të gjitha aspektet proce-



durale të kryerjes së një hetimi disiplinor dhe procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve; duke ofruar këshilla mbi praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare, përfshi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në fushën e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkëmbejnë eksperiencën mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve dhe standardizimin e procedurave të inspektimit; të zhvillojnë seanca praktike reciproke për punonjësit, duke forcuar njohuritë, përvojën dhe kapacitetet e palëve, nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe pune, takimeve për çështje me interes të

përbashkët ose aktiviteteve të përbashkëta trajnuese; organizimin e seminareve apo konferencave të përbashkëta për çështje të rëndësishme në procedimin disiplinor në terren dhe inspektimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë kësaj vizite pune delegacioni shqiptar u njoh nga përfaqësues të Këshillit të Shtetit grek me praktikën e procesit disiplinor, standardet bazë evropiane për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve; organet kompetente dhe procedurat për procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve në Greqi; sanksionet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe praktika përkatëse e Këshillit të shtetit.





Z. METANI PRITI DELEGACIONIN E QENDRËS SË SHTETIT TË SË DREJTËS TË FINLANDËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti në një takim kortezie delegacionin e Qendrës së Shtetit të së Drejtës të Finlandës, të kryesuar nga ish ministrja e Drejtësisë e Finlandës znj. Tuija Brax.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njohu bashkëbiseduesit me rolin dhe funksionet e ILD-së, si një nga institucionet e reja të Reformës në Drejtësi, që synon rritjen e besimit të qytetarëve tek sistemi i drejtësisë, përmes inkurajimit të standardeve më të mira të punës nga prokurorët e

gjyqtarët. “Një magjistrat nuk duhet të jetë përgjegjës vetëm për respektimin apo jo të normave ligjore, por edhe ndaj njerëzve, shoqërisë si dhe organeve të pushtetit shtetëror, duke ndikuar kështu, në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin

e publikut në sistemin e drejtësisë. Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë, pasi ai është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar se si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sundimi i ligjit në një vend.”,

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë, pasi ai është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar se si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sundimi i ligjit në një vend.”, u shpreh z. Metani



Znj. Brax shpjegoi se qëllimi i kësaj organizate është lidhja e ekspertizës dhe eksperiencës finlandeze mbi Shtetin e të Drejtës me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të përfitojnë prej saj. Aktualisht Qendra e Shtetit të së Drejtës e Finlandës është donator e bashkëzbatues me Internacional IDEA

(Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore) në projektin “Integriteti dhe Besimi të Zgjedhjet në Shqipëri: Nxitja e Transparencës së Financimeve Politike dhe Përdorimi i Sigurt i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit”.



SHKURT 2023


Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#)